



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 87 Prot.

Tiranë, më 13.01 . 2025

V E N D I M

Nr.15 , Datë 13.01. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 232 Regj, datë 13.11.2024, të paraqitur nga ankuesja znj.O. S kundër Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Misto Mame” Tiranë, Drejtores së IA-së znj.A.T dhe Zv.Drejtores znj. A.M , në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja O. S , ndër të tjera parashtron:

“Në raportimet sa i përket detyrës sime funksionale, drejtorja e shkollës i ka cilësuar problematikat e shqyrtuara si tendencioze, dashakeqe dhe të gënjeshtër, duke më fyer personalisht dhe profesionalisht në mënyrë zyrtare nëpërmjet shkresave. Nuk janë trajtuar problematikat si zyrtare por drejtorja e IA-së i ka devijuar si personale, lehtësisht të vërtetueshme nga kthim përgjigjet e saj me e-mail.

Më datë 23.10.2024 me anë të raportimit të incidentit, kam raportuar dhunën e ushtruar nga mësuesja e klasës së parë kundrejt një fëmije, e pranuar kjo nga mësuesja në prezencë të drejtuesve të IA-së dhe jo vetëm që nuk janë marrë masa por më janë kundërvënë nga drejtoresha e shkollës

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”, ankuesja ka përcaktuar si shkak “pozicionin e punës”.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

një pjesë e mësuesve, nëpërmjet pushtetit që ajo ka. Gjithashtu, drejtueset e IA-së më kanë ndaluar të ushtrij detyrën funksionale, atë të kontakteve me fëmijët dhe prindërit deri në miratim paraprak për çdo rast komunikimi dhe kjo krijon barriera, censurim të detyrës funksionale. Të gjitha këto vijnë fill pas raportimeve të cilat pasqyrojnë problematika të pabazuara në fakte. Gjuha e përbuzjes dhe presioni psikologjik i krijuar është mjaft i lartë për shkak të referimit të situatave problematike që cenojnë sigurinë e fëmijëve.

Ajo që kërkohet me insistim me veprimet dhe mosveprimet e drejtuesve të IA-së është tërheqja e kallëzimit penal dhe fshehja e dhunës nga ana ime si oficerë gjë e cila në institucione bie ndesh me parimet e drejtësisë, transparencës dhe përgjegjësisë. Fshehja ose injorimi i rasteve të dhunës nga oficeri i sigurisë në shkollë ka të bëjë me shkeljen e detyrës funksionale për të mbrojtur fëmijët dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të drejtë. Fshehja e dhunës kundërshton gjithashtu të drejtat e njeriut dhe nënvlerëson mundësinë për të parandaluar dhe trajtuar dhunën. Bazuar në interesin më të lartë të fëmijës nuk bëj kompromis në fshehje faktesh dhe në rastet ku dhuna psikologjike dhe presioni për vendin e punës është në nivele përtej normales.”

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri të marrë në shqyrtim ankesën, të vendosë sanksione administrative, të monitorojë zbatimin e ligjit në IA, si dhe t’u bëjë rekomandime autoriteteve përkatëse në lidhje me çështjen, Ministrisë së Arsimit, Zyrës Vendore Arsimore dhe drejtuesit të institucionit arsimor. Gjithashtu, ankuesja kërkon marrjen e masave për parandalimin e gjuhës denigruese të përdorur nga drejtueset e IA-së, trajtimin me dinjitet të personit të saj dhe ndalimin e përshkallëzimit të përpjekjeve dhe shantazhit për tërheqjen nga padia të fshehjes së rastit të dhunës nga këto drejtuese.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në nenin 12, pika 1, shkronja c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës. 2. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundrejt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve.”*

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkakun e pretenduar nga ana pala ankuese dhe provueshmërinë e disa prej deklarimeve kundrejt subjekteve kundër të cilave është paraqitur ankesa.

Me emalin e datës 21.11.2024, me qëllim plotësimin e ankesës, palës ankuese iu kërkua plotësimi i saj me informacionin dhe dokumentacionin përkatës provues për pretendimet e paraqitura në ankesë. Njëkohësisht ankuesja u kontaktua nëpërmjet telefonit në numrin e deklaruar në formularin e ankesës të depozituar pranë Komisionerit.

Në vijim, me anë të emalit të datës 10.12.2024, palës ankuese i është rikërkuar plotësimi i ankesës me e dokumentacionin dhe informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj. Njëherësh pala ankuese është telefonuar për disa ditë me radhë, por nuk i është përgjigjur telefonatave dhe njëkohësisht nuk ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4 . Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.”* Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, bazuar në arsyetimin vijues:

Bazuar në parashtrimet e depozituar nga pala ankuese, konstatohet se ankuesja O. S , ushtron funksionin si “oficere sigurie” pranë Shkollës 9-vjeçare “Misto Mame”, Tiranë. Për të provuar këtë pretendim ankuesja ka depozituar kopje të kartës me nr.297 regj, e cila nuk përmban të dhëna të tjera që të tregojnë statusin aktual të ankuses në raport me funksionin e ushtruar prej saj. Ankuesja

nuk depozitoi kopje të kontratës së punës/aktit të emërimit në funksionin e pretenduar, pavarësisht kërkesave të përsëritura nga ana e Komisionerit.

Ankuesja pretendon se, është diskriminuar në vendin e saj të punës menjëherë pas raportimeve të cilat pasqyrojnë problematika që lidhen me dhunën dhe cenimin e sigurisë së fëmijëve në institucionin arsimor ku ajo ushtron funksionin e oficeres së sigurisë. Nga dokumentacioni i depozituar nga ankuesja në mbështetje të pretendimeve të saj, u konstatua se ai nuk është në formën e kërkuar nga ligji për të provuar deklaratimet dhe pretendimet e ngritura nga pala ankuese. Aktet shkresore të depozituara nuk janë të nënshkruara apo në rast se janë komunikuar nëpërmjet mjeteve elektronike nuk janë të shoqëruara me kopje të *e-maileve* përkatëse, në mënyrë që të provohet vërtetësia e tyre. Pavarësisht kërkesave të përsëritura nga ana e Komisionerit, ankuesja nuk depozitoi dokumentacionin që provonte parashtrimet dhe deklaratimet e bëra nga ana e saj në ankesën objekt shqyrtimi.

Lidhur me provueshmërinë e deklaratimeve dhe pretendimeve të ankueses, Komisioneri, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar prej saj, që minimalisht të dëshmojë me prova shkresore apo të ndonjë forme tjetër të komunikimit zyrtar (e-maile,) pretendimet për sjelljen e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur pretendimin për diskriminim.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për plotësimin e ankesës, pala ankuese ka shprehur mungesë bashkëpunimi, duke u mos iu përgjigjur *e-maileve* apo telefonatave. Kjo mungesë e nivelit minimal të bashkëpunimit nga ana e ankueses me Komisionerin, si organi që duhet të hetonte pretendimet e saj, në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundëson vijimin e procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë. Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij. Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë dyshimin se mund të prezumohet diskriminimi. Pala ankuese nuk parashtrroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, që të jenë motivuar nga shkaqet e pretenduara.

Përfundimisht, për sa më sipër dhe në referim të nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.232, datë 13.11.2024, të paraqitur nga ankuesja znj. O. S , pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër_Pozicioni i punës
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim

⁴ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, Vendimin nr. 1, datë 08.01.2024, të KMD-së.